



Funded by  
the European Union



## **"Pasqyra e krisur" e rolit mediatik mbi " plagën" malinje të korrupsionit**

***Aleksandër Çipa***

*\* Aleksandri është gazetar me eksperiencë 22 vjecare. Aktualisht ai është i angazhuar në rolin e kryeredaktorit të gazetës "SHQIP", si dhe kryetar i Unionit të Gazetarëve në Shqipëri. Gjithashtu gëzon experience akademike mbi 15 vjçare. Prej vitesh tashme, Aleksandri përbën një zë të fuqishëm të aktivizmit dhe lobimit për kauza të ndryshme sociale, përfshirë antikorrupsionin.*

**Nëntor 2023**

*Ky artikull u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!", financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.*



"Pasqyra" më sfidante për korrupsionin në një shoqëri, mbeten mediat. Reporterët, kryesisht ata të raportimit të thelluar dhe investigativë, janë kërkuesit, gjurmuesit dhe sidomos faktembledhësit më të duruar, nëpër linjat diskrete të korrupsionit. Kjo kategori profesionistësh janë potencialisht në vijën e parë të kësaj përballjeje.

Qeverisës dhe administratorë publikë, si protagonistë të rafinuar të aferave dhe bëmave gjithëfarësojshe në fushën e abuzivizmit, shpërdorimit dhe kryesisht korrupsionit, kanë një histori vijimësisht tronditëse dhe denoncuese, me këtë rrjet gazetarësh dhe redaksitë e profilit.

Në Shqipëri, gjatë dhjetë viteve të fundit janë mbi 20 struktura redaksionale të gazetarisë së profilit investigativ që veprojnë dhe kanë krijuar përvojë cilësore. Në këto redaksi janë të rekrutuar mbi 50 gazetarë dhe 30 operatorë që kanë krijuar arkivën e pasur të rasteve të investiguara, të publikimeve dhe transmetimeve në zhanre audiovizive dhe online në krejt spektrin multimedial shqiptar.

Në hapësirën kohore të dy viteve të fundit 2022-2023 transmetimet apo publikimet e mbi 27 investigimeve kanë shërbyer si indicie për fillime procesesh hetimore dhe ngritje akuzash nga organet shqiptare të prokurorisë. Për këto hetime, deri në muajin nëntor, kemi pasur mbi 60 seanca gjyqësore.

Ndërkohë që nga prokuroritë ka pasur mbi 15 raste të thirrjeve në cilësinë e "personit me dijeni" të vetë gazetarëve që kanë raportuar faktet dhe dosjet e aferave, abuzimeve apo edhe shkeljeve të ndryshme ligjore.

Në mbi 20 herë gjatë kësaj periudhe, janë kërkuar në cilësinë e provës; materialet e publikuara nga prokuroritë prej mediave dhe redaksive që kanë realizuar investigimet, raportimet e thelluara dhe denoncimet e tyre mediatike.

Mjaftojnë këto të dhëna, për një periudhë të shkurtër kohore, të vërehet se sa i rëndësishëm dhe ndikues është roli i medias në pasqyrimin e korrupsionit si realitet, si bëmë, si dukuri dhe si sëmundje tronditëse për shoqërinë tonë e sidomos për të gjitha nivelet e administratës dhe qeverisjes së vendit. Aq më tepër që sipas raporteve periodike dhe indekseve ndërkombëtare, vendi ynë listohet ndër vendet me korrupsion endogjen dhe nivel të lartë.

Ky shërbim publik korrupsion-denoncues i mediave dhe reporterëve, natyrisht që nevojitet të jetë edhe më tepër i kurajshëm dhe këmbëngulës. Kjo është përballje e vështirë dhe veçanërisht me risqe.

Vetë sistemi politik është penguesi dhe refuzuesi potencial për dimensionimin e këtij shërbimi, për realizimin maksimal të informimit dhe raportimit prej mediave të korrupsionit dhe abuzivizmit zyrtar.

Mediave, veçanërisht reporterëve, u vihen një zinxhir i plotë pengesash për raportimin me transparencë dhe plotësi të fakteve, akteve, proceseve dhe skemave të abuzivizmit, korrupsionit dhe trafikimit të ndikimit për ekzekutime tenderimesh dhe prokurimesh me fonde e buxhete publike.

Indekset për transparencë dhe liri informimi në rastin e Shqipërisë kanë për çdo vit rënie.

Është një situatë në regres. Sistemi politik në vend, duke e mbajtur demokracinë në gjendje hibride dhe të rrënuar deri në tipare autokratike, ka zhveftësuar detyrimin ligjor për të qenë besnik dhe mishërues i praktikës ligjore për transparencë dhe informim.

Ankesat redaksionale dhe sidomos individuale nga një numër në shtim i gazetarëve, për mosrespektim të kërkesave për informacion specifik dhe për vënie në dispozicion të dokumentacionit për praktikat dhe proceset e ndjekura për; tendera, prokurime, koncensione dhe shërbime të tjera publike e komunitare, janë dëshmi autentike se sa e vështirë është. Mbërritja tek e vërteta nuk mjafton vetëm përmes kërimit apo zbulimit. Por, nevojitet të zotërosh një lëndë të plotë dokumentare, shkresuale, të dhënash procedurale dhe shenjash nëpër hallkat e veprimit burokratik e administrativ për çështjen që do të publikosh. Madje për këtë të fundit, beteja shpesh nuk është aq e thjeshtë.

Si autorë për shtimin e tyre nuk janë vetëm personazhet e investigimit apo raportimit brenda nëpunësisë apo nivelet e vendimarrësve, përkundrazi, ata bëhen më të shtuar, sa më i drejtëpërdrejtë dhe me aftësi "gërmuese" është gazetarja apo gazetari, aq më tepër redaksia. Këto mësymje penguesish përsëritshëm ia kanë dalë ta ndalin ose ndërpresin dhe madje edhe ta evitojnë, misionin pasqyrues të korrupsionit, aferave, abuzimit dhe shpërdorimit ligjor nga ana e mediave dhe reporterëve.

Gjatë vitit 2023, nga një pyetësor i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë rezultojnë të jenë mbi 50 raste dhe përvojash të investigimeve të ndërprera, të shmangura dhe të papublikuara për kësi aryesh.

Kësi pengimesh janë fakte të pastra censurimi, vetëcensurimi dhe praktikash të intimidimit dhe trafikimit të influencës edhe mbi mediat dhe prej gazetarëve. Kjo anë e "medaljes" është hise e rëndë mbi vetë autoritetin dhe integritetin besues ndaj mediave dhe gazetarëve.

Kësi tërheqjesh, ndaljesh dhe pengimesh, rëndom kanë krijuar edhe përplasje me përbaltje dhe akuzime, brenda entitetit dhe komunitetit profesional.

Parë me vëmendjen e shtrirjes dhe ndikimit shumëplanësh të korrupsionit në të gjitha fushat dhe shtresat e shoqërisë, pranohet se simptomat e tij kanë prekur vetë mediat. Kjo nuk është e panjohur në debatin publik.

Për vitin 2023 në gjykatat e vendit ka pasur 9 raste procesesh gjyqësore të hapura dhe ndjekura për shkak të akuzave ndaj gazetarëve prej gazetarëve ose mediave prej mediave, ku akuzojnë, denoncojnë dhe kallëzojnë, njeri kundër tjetrit, për gjobëvënie, intimidim, akuzime dhe kallëzime penale.

Ka qenë kjo stuhi akuzash dhe kundërakuzash brenda komunitetit profesional që ka tronditur marrëdhëniet etike, besueshmërinë dhe integritetin publik të gazetarit dhe mediave. Kjo anë e "medaljes" është hise e rëndë mbi vetë autoritetin dhe integritetin besues ndaj mediave dhe gazetarëve. Kësi tërheqjesh, ndaljesh dhe pengimesh, rëndom kanë krijuar edhe përplasje me përbaltje dhe akuzime, brenda entitetit dhe komunitetit profesional. Gjithashtu, ky kontekst dhe rastet në fjalë kanë aktualizuar zëra për nisma dhe veting edhe brenda mediave dhe gazetarëve.

Parë me vëmendjen e shtrirjes dhe ndikimit shumëplanësh të korrupsionit në të gjitha fushat dhe shtresat e shoqërisë, pranohet se simptomat e tij kanë prekur vetë mediat. Kjo nuk është e panjohur në debatin publik.

Misioni raportues dhe investigues për gjendjen e korrupsionit, prej mediave dhe gazetarëve, është shërbim përcaktues për shëndetin e shoqërisë, rolit funksional të shtetit ligjor dhe institucionalizmit, si dhe për vlerën reale të sistemit të drejtësisë në vend.

Këtë rol e bëjnë efiçent dhe me ndikim potent për shëndetin e keqësuar të krejt sistemit në vend, vetëm mediat dhe gazetarët. Bëhet fjalë për atë entitet gazetarësh dhe redaksish që mbeten të "ankoruar përherë " tek shtyllat morale, tek parimet deontologjike dhe sidomos që qëndrojnë larg dhe jashtë ndikimit e trafikimit të ndërhyrjeve apo pengimit, të pavarësisë së tyre raportuese e publikuese.